



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 183 , Datë 26 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.143, datë 12.09.2018, të znj.Z. A, kundër Bashkisë Tiranë¹, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të gjendjes ekonomike*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.Z. A është prind i fëmijës K. A, me moshë 2 vjeç. Ajo shprehet se në muajin Qershor të këtij viti ka dashur të regjistrojë fëmijën e saj në çerdhe, por nuk ka mundur ta regjistrojë për shkak të tarifës së lartë, të përcaktuar nga Bashkia Tiranë, për të gjithë fëmijët që frekuentojnë çerdhet dhe kopështet. Znj.Z. A shprehet se detyrimi mujor i përcaktuar është i papërbalueshëm për të, për shkak të kushteve ekonomike në të cilat ajo ndodhet. Ajo ka parashtruar se Vendimi nr.40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranë”, i Këshillit Bashkiak Tiranë ka përcaktuar kategoritë që përfitojnë pa pagesë shërbimin në çerdhe për fëmijët e tyre:

¹ Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, pranë Bashkisë Tiranë.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- Fëmijët me statusin e jetimit;
- Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit;
- Fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara;
- Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me kuadrin ligjor përkatës;
- Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Ankuesja shprehet se familja e saj nuk trajtohet me ndihmë ekonomike dhe aktualisht është e pa punë. E ndodhur në kushtet kur familja ime nuk mund të renditet në asnjërën kategori të listuar në VKB sipër përmendur, znj.Z. A shprehet se është e detyruar që fëmijën ta mbajë në shtëpi dhe të mos e çojë në çerdhe për shkak të pamundësisë për të paguar tarifën mujore.

Ankuesja pretendon se lënia jashtë grupeve përfituese të shërbimit pa pagesë në kopështe dhe çerdhe të familjeve që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike, por që nuk kanë burim tjetër të sigurtë e të qëndrueshëm të ardhurash mujore, përfshirë edhe atë; e ka vendosur në kushtet e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes ekonomike të saj, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

Në përfundim të ankesës së saj ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i

personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë faktin që trajtohet me ndihmë ekonomike, lidhur me shkakun e diskriminimit, përkundrazi, me shkresën me nr.2273/1 prot., datë 24.08.2018 vërteton se familja e znj.Z. A nuk trajtohet me pagesë së ndihmës ekonomike³. Pra, jemi në kushtet kur nuk provohet shkakun për të cilin ankuesja pretendon diskriminimin, pasi pikërisht mostrajtimi me ndihmë ekonomike vërteton faktin se familja është në mundësi ekonomike.

Pretendimi i subjektit ankues për diskriminim lidhur me mospërfitimin e ndihmës ekonomike, mund të bëhet objekt shqyrtimi nga KMD-ja, në kuadër të trajtimit si një ankesë të re, me dakortësinë e personit të interesuar, bazuar mbi prova të tjera dhe kundër subjekteve përgjegjëse për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.Z. A, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

³ Vërtetimi i Njësisë Administrative Njësia Bashkiake nr.4, Tiranë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Gjendja ekonomike